



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Duke u bazuar në nenin 80, nenin 81 të Ligjit Nr- 08 / L-197, për Zyrarët Publik, nenit 62, paragrafi 62,3 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 14, të Statutit të QKMF “Dr.Fatmir Krasniqi” Fushë Kosovë, nenin 4, dhe nenin 5. të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të Konkursit në sektorin publik dhe Propozimit nr.1205, Dt.10/11/2023, nga QKMF F.Kosovë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

K O N K U R S P Ë R P L O T Ë S I M I N E V E N D I T T Ë P U N Ë S

Titulli/vendi i punës: Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

Institucioni: QKMF Komuna Fushë Kosovë

Drejtorati: Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Lloji i pozitës: Zyrarë Publik,

Numri impozitive: 1 (një),

Titulli/koefficienti: H4 12,5

Lloji i emërimit: Me afat të caktuar (mandat 4 vjeçar me orar të plotë)

Numri i Referencës:

Detyrat dhe përgjegjësitë :

1. Menaxhon punën e përgjithshme të QKMF-së dhe cakton objektivat dhe zhvillon planet për përmbushjen e ketyreve objektivave;
2. Është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-ë si dhe për punën profesionale të QKMF-ës,
3. Është përgjegjës për implementimin e planit të burimeve njerëzore,
4. Menaxhon stafin e QKMF, dhe në bashkëpunim me Drejtorin e DSHMS, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
5. Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, i propozon për miratim DSHMS planin e punës dhe buxhetin e QKMF për vitin vijues;
6. Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
7. Analizon dhe vlerëson cilësinë e shërbimeve shëndetësore që i ofrohen pacientëve me qëllim të zbatimit të ndryshimeve për rritjen e efikasitetit në punë dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore;
8. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me shëndetësinë primare dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
9. Të zhvillon marrëdhënie të mira me donatorët, OJQ dhe me partneret për zbatimin e projekteve të tyre;
10. Kryen detyra të tjera të caktuara nga ana e Drejtorit/es të DSHMS,

Kushtet dhe kriteret:

- Të ketë përgatitje – Diplomë Universitare – Mjek Specialist nga Mjekësia Familjare (Diploma e vërtetuar)
- Të ketë së paku pesë vite përvojë pune në sistemin shëndetësor, prej tyre 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale,
- Të ketë referenca lidhur me programet trajnuese.
- Njohuri të kompjuterit.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e vërtetuar e Diplomës Universitare – Mjek Specialist nga Mjekësia Familjare
- Dëshmi për përvojën e punës,
- Dëshmi mbi përvojën menaxheriale,
- Dëshmi lidhur me programet trajnuese,
- Licencën e punës (Kopje e vërtetuar),
- Ekstraktin e Lindjes,
- Fotokopjen e Letërnjoftimit,
- Certifikatën shëndetësore (me rastin e përzgjedhjes)
- Certifikatën që ndaj tij / asaj nuk zbatohen hetimet.

INFORMATË E PËRGJITHËSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT**Mënyra dhe afati i aplikimit**

Pranimi në detyrë, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. Procesi përzgjedhës do të bazohet gjithashtu në një proces profesional, transparent e të drejtë, bazuar në vlerësimin e njohurive , aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, ku përfshihet një testim me shkrim dhe me gojë.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve, është 30 ditë, nga data: 21/11/2023, deri më: 20/12/2023, ora 16,00.

Përveç webfaqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës.

Aplikacionet merren në Arkivën e Komunës, ose mund të shkarkohet nga web-faqja zyrtare e Komunës së Fushë Kosovës, dhe të plotësuara dorëzohen personalisht në Arkivë të Komunës Fushë Kosovë ose dërgohen me postë në adresën Komuna Fushë Kosovë, Rruga "Tahir Zemaj" nr.2.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakumpletuara nuk do të pranohen.

